

VËSHTRIM MBI BIMËT AROMATIKO-MJEKËSORE TË QARKUT DIBËR, SHQIPËRI

ENTELE HYKA., ALEKO MIHO.

Departamenti i Biologjisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës.
e-mail: hykaentela@gmail.com

Përmbledhje

Në këtë punim jepen të dhëna mbi bimët aromatiko-mjekësore (BAM) (aspekte floristike dhe ekonomike) të Qarkut Dibrës (Peshkopi, Bulqizë). Bëhet fjalë për rreth 100 lloje bimore të mbledhura në vite, ku rreth 70 prej tyre duket se mbledhen edhe sot. Nga të dhënat, duket se mundësitë për zhvillimin e këtij sektori nuk janë të pakta. Nga ana tjetër, një pjesë e mirë e llojeve (rreth 25%) kanë nivele të ndryshme kërcënimi, për rrjedhojë, rëndësi duhet t'u kushtohet edhe shqetësimeve nga shfrytëzimi i tepruar (i pa qëndrueshëm) në grumbullimin e tyre.

Fjalëkyçet: Bimët aromatike dhe mjekësore (BAM), Qarku Dibër, vjelje e qëndrueshme.

Abstract

Information on the medicinal and aromatic plants (MAPs) of the Dibra County (floristic and economic aspects) (Peshkopi, Bulqiza) will be reported here. There are about 100 plant species harvested in years, where 70 of them continue to be harvested nowadays, too. It seems that opportunities for development of this sector are not limited. On the other hand, a good part of MAP species (about 25%) have different level of threat; hence, importance is also addressed to the concerns about excessive and non-sustainable harvesting.

Key words: Medicinal and aromatic plant (MAPs), Dibra County, sustainable harvesting.

Hyrje

Bimët prodhojnë me qindra lëndë kimike organike që ne përdorim si ilaçe ose çajra. Disa prej tyre, të njohura si bimë aromatike-mjekësore (BAM), përdoren në sasi të madhe në industrinë farmaceutike europiane dhe botërore, si lulebasani (*Hypericum perforatum*), murrizi (*Crataegus* sp.), sherbela (*Salvia officinalis*), rigoni i bardhë (*Origanum vulgare* subsp. *viridulum*), hithra (*Urtica dioica*) etj. (Imami *et al.*, 2015; Gjoni, 2009)

Shqipëria, me florën e saj të pasur me mbi 3500 lloje bimësh të larta, është ndër vendet grumbulluese dhe eksportuese me peshë të BAM. Qarku i Dibrës (Peshkopia, Bulqiza) dallohet për këtë pasuri biologjike natyrore me vlerë ekonomike (IKPK, 1988; Gjoni, 2009; 2011; 2017).

Nga ana tjetër, kohët e fundit rreth 300 lloje të bimëve aromatike-mjekësore ose etero-vajore janë në mbrojtje dhe grumbullim natyror të kufizuar, për shkak të shfrytëzimit të tepruar (VKM 31(2016)). Ashtu si gjithë pasuritë e tjera natyrore edhe këto kërkojnë shfrytëzim me kujdes, duke ruajtur dhe ripërtëritur vazhdimisht vlerat e tyre. Kjo ishte arsyeja që menduam të trajtojmë këtu këtë aspekt të rëndësishëm të florës sonë, duke patur në

vëmendje kryesisht bashkitë Dibër dhe Bulqizë të Qarkut Dibër.

Materiali dhe metoda

Shkas për këtë punim u bë punimi i mikrotezës së Hyka (2018) lidhur me mundësinë që ka përdorimi i BAM në mësimdhënie AML me në fokus zonën e Dibrës (Peshkopi dhe Bulqizë). Për këtë u mbështetëm tek një material dorëshkrim lidhur me inventarizimin gjithëpërfshirës të BAM në Shqipëri të kryer në Prill 1988, nga ish stacioni i Pyjeve dhe Kulturave Etero-Vajore, Tiranë (IKPK, 1988). Aty jepet informacion i hollësishëm mbi shpërndarjen në hektarë sipas rretheve të dikurshme, potencialin prodhues në tonë për 210 lloje bimore me vlera mjekësore dhe farmaceutike, përfshirë këtu edhe vlerën ekonomike për secilin lloj. Këto të dhëna u përditësuan për zonën e Dibrës lidhur me gjendjen sot duke parë publikimet më në zë, si ato të Gjoni (2007; 2011; 2017), IKPK (1988), Pazari (2014), VKM 31(2016), etj., si dhe me kontakte vetijake të autores Hyka nga zona.

Rezultate

Qarku i Dibrës ndodhet në pjesën Veri-lindore të Shqipërisë, i cili përfshin sot tre rrethet e dikurshme, Dibrën, Bulqizën dhe Burrelin. Në këtë punim ne marrim në analizë vetëm dy bashkitë kryesore të këtij Qarku, atë të Dibrës dhe Bulqizës; këto sëbashku zënë një hapësirë relativisht të madhe me rreth 161,639 ha, dhe një popullsi prej rreth 93,800, banorë (2011) (<http://pushtetivendor.reporter.al/>).

Zona shtrihet kryesisht në luginën e Drinit dhe përgjatë degëve të tij (Kabo, 1990-91). Ekonomia në zonën urbane mbështetet kryesisht në shërbime, tregti, hoteleri-turizëm, përpunim dhe ndërtim, ndërsa zona rurale ka karakter të qartë bujqësor-blegtoral (Alku *et al.*, 2016). Mbështetur nga larmia e relievit dhe kushtet klimatiko-tokësore, Dibra dallohet për larmi bimore të pasur, e përfaqësuar nga gjithë katet e bimësisë, shkurretat mesdhetare, dushqet, halorët dhe ahishtet, si dhe kullotat alpine. Rreth 24,300 ha janë pyje (rreth 17.5% e gjithë hapësirës së Qarkut), dhe 12,899 ha kullota dhe livadhe (rreth 10%).

Për rrjedhojë, sektori i BAM përbën mundësi të madhe për zhvillimin ekonomik të gjithë Qarkut Dibër. Mbështetur në inventarin e vitit 1988 (IKPK, 1988), rreth 100 lloje janë mbledhur në natyrë në vite si bimë aromatike-mjekësore; lista e plotë jepet në tabelën 1; rreth 70 prej tyre duket se mblidhen edhe sot sipas të dhënave të përditësuara (Gjoni, 2009; 2011; 2017; IKPK, 1988; Pazari, 2014; etj.). Përhapjen më të madhe në natyrë duket se e kanë dëllinja e kuqe (*Juniperus oxycedrus*), boronica (*Vaccinium myrtillus*), lajthia (*Corylus avellana*) dhe trëndafili i egër (*Rosa canina*).

Tabela 1: Pasqyrë përmbledhëse mbi bimët mjekësore të rrethit të Dibrës (sot kryesisht bashkitë Dibër dhe Bulqizë) që janë mbledhur para viteve 1990-të, bashkë me sipërfaqen në hektarë, sasinë në tonë, përfshirë dhe vlerën në US\$ të asaj kohe (IKPK, 1988), si dhe ato që mblidhen ende sot (sipas Gjoni, 2009; 2011; 2017; IKPK, 1988; Pazari, 2014; etj.) dhe shkalla e kërcënimit (VKM 31(2016)).

Emri shkencor	Emri popullor	Organi që mblidhet	Sipërfaqe, ha	Sasia, t	Vlera, x 1000 US\$	Mblidhet sot	Kërcënimi
Likene / Lichens							
<i>Lichen fagus</i>	Myshk ahu	myshk	-	5	2	Jo	
<i>Lichen planus</i>	Myshk pishe	myshk	-	20	10	Jo	
<i>Lichen quercus</i>	Myshk dushku	myshk	-	2	1	Jo	
Fierna / Ferns							
<i>Equisetum arvense</i>	Bishtkali	bar	35	0.2	3	Po	
Gjimnosperme							
<i>Abies alba</i>	Bredhi i bardhë	hala	96	237	3	Jo	
<i>Juniperus communis</i>	Dëllënjë e zezë	fryte	2825	66	66	Po	VU Alb
<i>Juniperus oxycedrus</i>	Dëllënjë e kuqe	fryte	671	18	38	Po	VU A1b
<i>Pinus heldreichii</i> (= <i>P. leucodermis</i>)	Rrobulli	hala	40	320	3	Jo	VU D2
<i>Pinus nigra</i>	Pishë e zezë	hala	379	950	9	Jo?	
Angiosperme: Eudikote etj.							
<i>Achillea millefolium</i>	Mijëfletëshi	gjithë bima	-	14	7	Po	
<i>Aesculus hippocastanum</i>	Gështenjë kali	lëvore	-	0.2	0.2	Jo	CR A1a
<i>Althaea officinalis</i> (= <i>Malva officinalis</i>)	Mëllaga e bardhë	lule	-	0.2	1	Po	
<i>Arctium lappa</i> (= <i>Lappa major</i>)	Rrodhe	rrënjë, gjethe, fara	-	1	1.5	Po	

Emri shkencor	Emri popullor	Organi që mblidhet	Sipërfaqe, ha	Sasia, t	Vlera, x 1000 US\$	Mblidhet sot	Kërcënimi
<i>Arctostaphylos uva-ursi</i>	Rrush arushe	gjethe	-			Po	LR cd
<i>Artemisia absinthium</i>	Pelini	gjithë bima	-			Po	
<i>Bellis perennis</i>	Luleshqerrë	lule	-	1	1	Po	
<i>Betula pendula</i>	Mështekna	gjethe	40	18	7	Po	CR B2e
<i>Capsella bursa-pastoris</i>	Trastë bariu	gjithë bima	-	12.2	6	Jo	
<i>Castanea sativa</i>	Gështenja	gjethe	185	30	10	Po	
<i>Centaurea cyanus</i>	Kokoçeli	lule	-	1.8		Jo	
<i>Cicharium intybus</i>	Çikore	lule, rrënjë	122	2.7	5.5	Po	
<i>Corylus avellana</i>	Lajthia	gjethe, fryte	2093	263	112	Po	
<i>Cotinus coggygria</i>	Cëmërdell	gjethe, bisqe	138	30		Jo	
<i>Crataegus monogyna</i>	Murriz njëbërthamor	lule, gjethe, fryte	-	2.7	12	Po	
<i>Crataegus oxyacantha</i>	Murriz dybërthamor	lule, gjethe, fryte	-	3.1	3	Po	
<i>Datura stramonium</i>	Tatulla	gjethe	-	2	1	Jo	
<i>Digitalis lanata</i>	Lulefilxhani	gjethe	-	0.1		Jo	LR cd
<i>Fragaria vesca</i>	Luleshtrydhja	gjethe, rrënjë, fryte	-	6	7	Po	
<i>Fraxinus excelsior</i>	Frashër i zi	gjethe	3	1	0.25	Jo	CR A1b
<i>Fraxinus ornus</i>	Frashër i bardhë	gjethe	203	12	4	Jo	
<i>Gentiana lutea</i>	Sanzi	rrënjë	-	10	26	Po	EN A1b
<i>Helichrysum arenarium</i>	Lule akulli	lule	-	1.07	4	Po	
<i>Hypericum perforatum</i>	Lulebasani	gjithë bima	-	3	4	Jo	EN A1b

Emri shkencor	Emri popullor	Organi që mblidhet	Sipërfaqe, ha	Sasia, t	Vlera, x 1000 US\$	Mblidhet sot	Kërcënimi
<i>Juglans regia</i>	Arra	gjethe, lëvore	358	330	162	Po	EN A1b
<i>Malus sylvestris</i>	Molla e egër	fryte, lule, gjethe	-	14.2	8	Po	
<i>Matricaria chamomilla</i> (= <i>M. recutita</i>)	Kamomili	lule	-			Po	
<i>Melilotus officinalis</i>	Jonxha e egër	gjithë bima	-	1.3	1	Po	
<i>Melissa officinalis</i>	Bar blete	gjithë bima	-	0.4		Jo	
<i>Mentha longifolia</i>	Mendra gjethe gjatë	gjithë bima	-	12.2	5	Jo	
<i>Mentha pulegium</i>	Mendra pulegë	gjithë bima	-	0.2		Jo	
<i>Morus alba</i>	Mani i bardhë	gjethe	-			Jo?	
<i>Morus nigra</i>	Mani i zi	gjethe	-			Jo?	
<i>Ononis spinosa</i>	Gjuhënuse	rrënjë	-	8	9	Po	
<i>Origanum vulgare</i>	Rigoni i kuq	gjithë bima	-	0.6	0.3	Po	EN A1b
<i>Origanum vulgare</i> subsp. <i>viridulum</i>	Rigoni i bardhë	gjithë bima	-	0.4	0.2	Po	EN A1b
<i>Papaver rhoeas</i>	Lulekuqja	lule	-	1.1	5	Po	
<i>Parietaria officinalis</i>	Parietaria	gjithë bima	-	1	1	Jo	
<i>Phaseolus vulgaris</i>	Fasule	lëvore	700	13	6	Po	
<i>Plantago lanceolata</i>	Gjethedelli	gjethe	-	4	3	Po	
<i>Plantago major</i>	Gjethedelli i madh	gjethe	-	2	1	Po	

Emri shkencor	Emri popullor	Organi që mblidhet	Sipërfaqe, ha	Sasia, t	Vlera, x 1000 US\$	Mblidhet sot	Kërcënimi
<i>Plantago media</i>	Gjethedelli mesatar	gjethe	-	2	2	Po	
<i>Polygonum aviculare</i>	Barpate	gjithë bima	34	6	3	Po	
<i>Populus nigra</i>	Plepi i zi	sytha	2	1.1		Jo	
<i>Primula grandiflora</i>	Aguliçia lulemadhe	gjithë bima	-			Po	
<i>Primula veris</i> (= <i>P. officinalis</i>)	Aguliçia	lule	-	8	38	Po	
<i>Prunus cerasus</i> (= <i>Cerasus vulgaris</i>)	Qershia	bishtat	37	0.6	1	Po	
<i>Prunus spinosa</i>	Kulumbria	lule, fryte	-	7.4	9	Po	
<i>Robinia pseudoacacia</i>	Akacia	lule	541	12	10	Po	
<i>Rosa canina</i>	Trëndafili i egër	fryte	2092	68	34	Po	
<i>Rubus caesius</i>	Ferra	fryte	-			Po	
<i>Rubus fruticosus</i>	Ferrëmanëza	gjethe, fryte	-	29	20	Po	
<i>Rubus idaeus</i>	Mjedra	gjethe, fryte	80	15.6	10	Po	
<i>Salix alba</i>	Shelgu i bardhë	thupra, lëvore	-			Po	
<i>Salix nigra</i>	Shelgu i zi	thupra	112	672	47	Po	
<i>Salix ssp.</i>	Shelgje të tjera	thupra	153	1408	98	Po	VU A1b
<i>Salix viminalis</i>	Shelgu industrial	thupra, lëvore	35	420	29	Po	
<i>Salvia officinalis</i>	Sherbela	gjethe	783	30	24	Po	VU Alb
<i>Salvia sclarea</i>	Shëngjini	gjithë bima	-			Po	

Emri shkencor	Emri popullor	Organi që mblidhet	Sipërfaqe, ha	Sasia, t	Vlera, x 1000 US\$	Mblidhet sot	Kërcënimi
<i>Sambucus ebulus</i>	Qingël	rrënjë	18	27	10	Jo	
<i>Sambucus nigra</i>	Shtogu	lule, fryte, lëvore	-	3.2	7	Po	VU Alb
<i>Saponaria officinalis</i>	Lulesapuni	rrënjë	-	0.2		Jo	
<i>Satureja montana</i>	Trumza	gjithë bima	80	17	5	Po	VU A1c
<i>Sideritis raeseri</i>	Çaji i malit	gjithë bima	10	0.6		Jo	
<i>Sorbus aucuparia</i>	Vodhja e egër	fryt	-	0.2	0.2	Po	
<i>Taraxacum officinale</i>	Luleshurdha	gjethe, rrënjë	23	1.5		Jo	
<i>Teucrium chamaedrys</i>	Arrsi	gjithë bima	-	7	4	Po	
<i>Teucrium polium</i>	Bar majasëlli	gjithë bima	197	5.4		Jo	
<i>Thymus serpyllum</i>	Zhumbrica	gjithë bima	222	18.6	12	Po	
<i>Tilia platyphyllos</i> (= <i>T. officinarum</i>)	Bliri	lule, gjethe	-	0.5	1	Po	CR Alc
<i>Tilia tomentosa</i> (= <i>T. argentea</i>)	Bliri i argjentë	lule	-	1	3	Po	
<i>Trifolium pratense</i>	Tërfili i kuq	lule	-			Po	
<i>Tussilago farfara</i>	Thundërmushka	lule, gjethe	-	9	6	Po	
<i>Tussilago hybrida</i> (= <i>Petasites hybridus</i>)	Llapoi	rrënjë	-			Po	
<i>Urtica dioica</i>	Hithër	rrënjë, gjethe	17	13	6	Po	
<i>Vaccinium myrtillus</i>	Qershigla, boronica	gjethe, fryt	2500	65	184	Po	VU A2b
<i>Verbascum thlaspiiforme</i>	Netulla	lule, gjethe	-	0.5	1	Po	

Emri shkencor	Emri popullor	Organi që mblidhet	Sipërfaqe, ha	Sasia, t	Vlera, x 1000 US\$	Mblidhet sot	Kërcënimi
<i>Verbascum phlomoides</i>	Netulla flomide	lule	1	0.3	1	Po	
<i>Viola odorata</i>	Manushaqe	rrënjë	-			Po	
<i>Viscum album</i>	Veshtulla	gjethe, fryt	-			Po	VU A1c
<i>Vitis vinifera</i>	Hardhia	fryt	-			Po	
Angjosperme: Monokote							
<i>Colchicum autumnale</i>	Xherrokulli	fara	-	0.1	1	Po	EN A1b
<i>Cynodon dactylon</i>	Grami	rrënjë	166	41.8	21	Jo	
<i>Iris florentina</i>	Shpatore	rizoma	-			Po	
<i>Iris germanica</i>	Shpatore	rizoma	-			Po	
<i>Iris pallida</i>	Shpatore	rizoma	-			Po	
<i>Orchis</i> spp. (=Salep pulvis)	Salepi	zhardhokë	Salepi	0.2	2.8	Po	VU A1b
<i>Ophrys</i> spp.(=Salep pulvis)	Salepi	zhardhokë	Salepi			Po	VU A1b
<i>Veratrum album</i>	Shtara	rrënjë	-	0.4	0.1	Jo	
<i>Zea mays</i>	Misri	mustaqe	-	9	4	Po	
Shuma				5,296	1,127	69	23

Deri në 1988 duket se janë mbledhur mbi 5300 t BAM në vit në ish rrethin e Dibrës, me të ardhura të përlogaritura mbi 1,140,000 US\$, ose rreth 7.8% e Buxhetit të Qarkut Diber për vitin 2018 (*Anonymous*, 2018); peshën më të madhe ekonomike e kanë patur boronica (gjethe, fryte), shelgjet (thupra, lëvore), arra (gjethe, lëvore), lajthia (gjethe, fryte), dëllinjat (fryte).

Sot ka pak të dhëna edhe mbi sasinë e saktë të BAM që mblidhen në hapësirën e Qarkut të Dibrës, si dhe të ardhurat që përfitohen; megjithatë, nga të dhënat e tabelës 1 duket se mundësitë për zhvillimin e këtij sektori nuk janë të pakta. Duket se nuk ka të dhëna nëse grumbullohen sot për eksport gjithë llojet e likeneve, halat e gjimnospermeve, gjethet e frashërit, tatullës, lulefilxhanit, sythat e plepit, rrënjët e qingjlës, lulesapunit, shtarës, gramit, bimë çajmali, lulebasani, barblete, mendre, trastëbariu, lëvore gështenje kali, lule kokoçeli, etj. Megjithatë, duhet thënë se grumbullimi i tyre edhe në të kaluarën nuk kishte ndonjë peshë të madhe, si nga ana sasiore dhe ekonomike (Tab. 1). Për më tepër, disa prej tyre janë bimë të kërcënuara, si çaji i malit, rrobulli, gështenja e kalit, lulefilxhani, etj.

Nga tabela 1 duket se shumë lloje (rreth 25%) janë pjesë e Listës së Kuqe (VKM 31(2016)) me nivele të ndryshme kërcënimi; ndër to përmendim: rrodhen (*Arctium lappa*), rrushin e arushës (*Arctostaphylos uva-ursi*), pelinin (*Artemisia absinthium*), mësh teknën (*Betula pendula*), cianin (*Centaurea cyanus*), dëllinjat (*Juniperus communis*), aguliçen (*Primula veris*), sherbelën (*Salvia officinalis*), trumzën (*Satureja montana*), blirin (*Tilia platyphyllos*) etj. Për këtë, rëndësi dhe vëmendje në këtë sektor duhet t'i kushtohet edhe shfrytëzimit të tepruar (të pa qëndrueshëm) në grumbullimin e tyre.

Vlen të theksohet se për vlerat natyrore dhe biodiversitetin, një pjesë e mirë e hapësirës natyrore të Qarkut Diber është e mbrojtur (<http://akzm.gov.al/lista-zonave-mbrojtura>). Vlen t'i përmendim këtu: Parkun Kombëtar të Lurës (kategoria II, IUCN), me 1043 ha, me 812.6 ha pyje, 49.8 ha livadhe, 153.8 ha sipërfaqe shkëmbore dhe 26.7 ha pasqyrë ujore); Rezervatin Natyror të Menaxhuar / Parkun Natyror Korab-Koritnik (IV; 20,663 ha në territorin e qarkut Diber), i përfaqësuar nga të gjitha katet bimore, duke filluar nga shkurretat mesdhetare, dushqet, halorët dhe ahishtet, e deri te kullotat alpine; etj. Pra rreth ¼ e gjithë hapësirës së Qarkut (pra 25%) është e mbrojtur, me vlera të veçanta natyrore dhe biologjike; kjo është shumë mbi vlerën e hapësirës së mbrojtur në mbarë vendin (prej 16%). Një gjë e tillë përbën vërtet një pasuri vlerash natyrore dhe biodiversiteti, por edhe është përgjegjësi, dhe kërkon kujdes të veçantë prej gjithë ndërhyrjeve të njeriut, përfshirë këtu edhe sektorin e BAM.

Literatura

Alku B., Manga L., Mehmeti Z. (2016): Strategjia e Territorit Bashkia Diber. Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp); HELVETAS Swiss Intercooperation (HSI) Albania. 113 f.

- http://www.km.dldp.al/wp-multimedia/st/diber/Strategjia_Territorit_Diber_draft%2026_2_2016-final.pdf
- Anonymous (2018): Buxheti 2018, Qarkut Dibër. <https://portavendore.al/wp-content/uploads/2018/04/Bashkia-Diber-Buxheti-2018.pdf>
- VKM 31(2016): Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike për mbrojtjen e biodiversitetit. Felpre zyrtare, 8(2016): 100 f.
- http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/8-2016.pdf
- Gjoni Z. (2009): Vjelja dhe grumbullimi i bimëve mjekësore të Dibrës. Peshkopi. Dorëshkrim. 111 f.
- Gjoni Z. (2011): Prespektivat aktuale dhe prespektivat e zhvillimit rural-bujqësor të qarkut Dibër. Mikrotezë. Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i bujqësisë dhe mjedisit, Departamenti i prodhimit bimor. 78 f.
- Gjoni Z. (2017): Vlerësimi i treguesve morfo-biologjik dhe biokimik të rrushit të ariut (*Archtostryphyllos uva-ursi* (L.) Spreng). Doktoratë. Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit, Universiteti Bujqësor i Tiranës. 170 f.
- Hyka E. (2008): Bimët aromatike mjekësore (BAM) në kurrikulën e arsimit parauniversitar – në fokus Qarku i Dibrës. Mikrotezë AML, DB, FShN, UT. 44 f.
- IKPK (1988): Studim për inventarizimin e bimëve mjekësore, etero-vajore dhe tanifere në RPSSH (dorëshkrim). Stacioni i Pyjeve dhe Kulturave Etero-Vjaore, Tiranë. 317 f.
- Imami D., Ibrahimi A., Fasllia N., Gruda N., Skreli E. (2015): Analysis of the medicinal and aromatic plants value chain in Albania. *Gesunde Pflanzen*, 67(4): 155-164.
- Kabo M. (Ed). (1990–91): Gjeografia Fizike e Shqipërisë, Vol. I (1990: 400 f.) dhe II (1991: 590 f.). Akademia e Shkencave, Tiranë
- Pazari F. (2014): Vlerësimi ekonomik dhe ekologjik i bimëve mjekësore dhe aromatike të shqipërisë në funksion të zhvillimit të ekonomisë rurale. Doktoratë. FHF, UT: 236 f.
- <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/ep-content/uploads/2014/11/Doktoratura-Florina-Pazari-Fakulteti-i-Historise-dhe-i-Filologjise-Departamenti-i-Gjeografise.pdf>